



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 64 par.2 pika a) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT –PLANIN PËR VENDOSJEN E
OBJEKTEVE TË PËRKOHËSHME NË PRONËN PUBLIKE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës dhe në Tabelën e Shpalljeve:

Draft- Plani për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme në pronën publike , më së largu me 26 janar 2018.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

1Nr. - 016 - 3289
Lipjan, më 16.01.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

